



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 160/2/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Sali Toplica, anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën e Danush Ademi në cilësinë e Kryetarit të Partisë Demokratike të Ashkalive të Kosovës (PDAK) dega ne Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit të KZAP-it, Anr.160/2010 të datës 21.05.2010, në seancën mbajtur me 16 Korrik 2010, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë kërkesa si e palejueshme.

A R S Y E T I M I

Danush Ademi, në cilësinë e Kryetarit të PDAK-së, dega ne Fushë Kosovë, ka paraqitur një kërkesë kundër vendimit të KZAP-it, Anr.160/2010 të datës 21.05.2010. Parashtruesi i kërkesës pretendon që të bëhet edhe njëherë rishqyrtimi i vendimit Anr. 160/2010 të datës 21.05.2010, në lidhje më gjobën e subjektit politik Bashkimi Demokratik i Ashkalive (BDA), sipas parashtruesit të kërkesës shkeljet dhe provokimet të cilat kanë ndodhur janë evituar brenda ditës.

KZAP-i, ka vendosur lidhur me apelet e subjekteve politike PDAK dhe BDA për rishqyrtimin e vendimit Anr.75/2009 të datës 19.04.2010, apelet janë refuzuar si të pabazuar më vendimin Anr.160/2010 datë 21.05.2010, lidhur më këtë vendim parashtruesi i kërkesës pretendon që të bëhet prapë rishqyrtimi dhe të vendoset ndryshe.

F A K T E T

Më 02 qershor 2010, KZAP-i, ka pranuar një kërkesë nga Danush Ademi, në cilësinë e Kryetarit të PDAK-së, dega ne Fushë Kosovë, kundër vendimit të KZAP-it, Anr.160/2010 të datës 21.05.2010, në të cilën thekson që të bëhet rishqyrtimi i vendimit Anr.160/2010 të datës 21.05.2010, më propozim që gjoba e shqiptuar të fshihet apo të zbutet, ngase sipas parashtruesit të kërkesës ky subjekt politik e përfaqëson një popullatë të varfër në Kosovë.

A N A L I Z Ë

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Pas shqyrtimit paraprak te kërkesës KZAP, konstaton se kërkesa e parashtruar nga Kryetari i PDAK-së, e pranuar më 02.06.2010, është një çështje e gjykuar. Lidhur më kërkesën e parashtruar, KZAP ka marr vendim Anr. 75/2009 më datë 19.04.2010, ndërsa për apelet që janë parashtruar kundër vendimit të lartë cekur, KZAP-i ka marr vendim Anr.160 më datë 21.05.2010, andaj siç rezulton nga shkresat e lëndës KZAP vjen në konkludim se pasi që nuk lejohet për të njëjtën çështje të vendoset dy herë (*res iudicata*), kërkesa hedhet poshtë si e palejueshme.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 160/2/2010 më datën 16 Korrik 2010

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

